REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS VRHOVNI SUD KOSOVA
GJ.A-Su.A 183/2019
Dt: 31/05/2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 30 maj 2019, me shumicë votash, miratoi këtë:

U DH Ë Z I M

a) Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. **06/L-074,** i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019, në kapitullin XXX, ka paraparë Veprat Penale kundër sigurisë së trafikut publik. Kësisoj, në nenin 370 është paraparë edhe vepra penale Rrezikimi i trafikut publik. Sipas kësaj dispozite ligjore, në paragrafin 1. përcaktohet se: "Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëme të konsiderueshëm pasurore". Paragrafi 2. sanksionon këtë vepër penale, nëse me shkeljen e Ligjit mbi trafikun rrezikohet trafiku hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujor.
Paragrafi 3. në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se: "Nëse veprat penale nga paragrafi 1 ose 2, të këtij neni rezultojnë me dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë "ndërsa paragrafi 4 parasheh si vepër penale nëse ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me dëm pasuror, në vlerë prej njëzet mijë (20.000) Euro apo më shumë, si dhe paragrafi 5, nëse ka rezultuar me vdekjen e një ose më shumë personave.

b) Në bazë të dispozitave të nenit 370 të KPK-së, të cekura në pikën a) të këtij Udhëzimi, tani më nuk parashihet vepra penale Rrezikimi i trafikut publik, e cila rezulton me lëndime të lehta trupore.
c) Të gjitha rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, e të cilat kanë rezultuar me lëndime të lehta trupore, Organi i kundërvajtjes duhet t'i parashtrojë Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, gjykatës kompetente themelore – Divizionit për Kundërvajtje.

d) Lëndët, të cilat janë në punë, në Gjykatat Themelore të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 ose 2 të KPK-së, të shfuqizuar, në të cilat nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor, duhet të hidhen, ndërsa nëse ka filluar shqyrtimi gjyqësor, gjykata duhet ta vendos në bazë të aktgjykimit refuzues.

   Lëndët do t'i procedohen organit të kundërvajtjes për inicimin e procedurës së kundërvajtjes sipas Ligjit për Kundërvajtje.

e) Për kryesin e dënuar me aktgjykim të formës së prerë me KPK-në e mëparshme, të shfuqizuar, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet, në rast se ka filluar.

A r s y e t i m

Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. **06/L-074** nga data 14 prill 2019, janë krijuar probleme në praktikë, sa i përket zbatimit të tij, sidomos në dispozitën e nenit 370 të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik, si nga ana e gjykatave, prokurorive ashtu edhe te organi i kundërvajtjes. Kryetarit të kësaj gjykate, i është drejtuar me parashtresë edhe U.D., Drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor, Nënkolonel Jeton Rexhepi, si dhe ka pasur biseda me kryetarë të gjykatave dhe prokurorë të shtetit si dhe me Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, rreth zbatimit konkret të kësaj dispozite ligjore, për veprimet e mëtutjeshme në menaxhim, trajtim si dhe procedim të rasteve të rrezikimit të trafikut publik, i cili ka rezultuar me lëndime të lehta trupore.

Fillimisht, dega penale e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjatë analizës paraprake ka marrë qëndrim, që në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, ka kompetencë, mes tjerash edhe të nxjerr një Udhëzim, i cili do të shërbejë për trajtimin në mënyrë unike, veprimet, të secilit organ, pas hyrjes në fuqi të këtij kodi.

Kësisoj, gjatë analizës u konstatua si vijon:

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019, në kapitullin XXX i ka paraparë të gjitha veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, ndërsa vepra bazë e cila ka qen objekt i trajtimit ka qenë vepra penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370. Në paragrafin 1 dhe 2 përkufizohen në mënyrë të përgjithshme shkeljet e ligjit mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikohet jeta e njerëzve apo pasuria dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror.

Paragrafi 3 i kësaj dispozite ligjore, përkufizon elementet qenësore të veprës penale - Rrezikimi i trafikut publik në atë mënyrë që për ekzistimin e kësaj vepre penale përcakton se, nëse veprat penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni, rezultojnë me dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë "ndërsa paragrafi 4. parasheh si vepër penale nëse ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me dëm pasuror në vlerë prej njëzet mijë (20.000) Euro apo më shumë, si dhe paragrafi 5. nëse ka rezultuar me vdekjen e një ose më shumë personave. Pra për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet të përcaktohet vlera e dëmit pasuror pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë, pastaj, nëse ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me dëm pasuror në vlerë prej njëzet mijë (20.000) Euro apo më shumë, si dhe nëse ka rezultuar me vdekjen e një ose më shumë personave.

Në dispozitat e Kodit në fuqi, përkundër Kodit Penal të shfuqizuar, i cili, në nenin 378 ka paraparë veprën penale, Rrezikim i trafikut publik, i cili në paragrafin 1 përcakton se: "kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror", si element qenësor të veprës penale, nuk ka paraparë shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor. Kështu që, në rastin konkret, ligjdhënësi, sipas dispozitës ligjore të nenit 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ka paraparë si masa të veçantë për kundërvajtje, në paragrafin 2, se, "Nëse është shkaktuar aksident trafiku me persona të lënduar, kryesi i kundërvajtjes nga ky ligj, dënohet me gjobë të paraparë për atë kundërvajtje, duke e rritur shumën për 200 euro".

Duke vlerësuar këtë situatë ligjore, konstatojmë se të gjitha rastet e rrezikimit të trafikut publik, të cilat rezultojnë me lëndime të lehta trupore, në veprimet e kryesve, mund të sajohen vetëm elementet qenësore të kundërvajtjes.

Duke analizuar kompetencën lëndore të organeve kompetente, sa i përket trajtimit të kundërvajtjeve, bazuar në legjislacionin në fuqi, konstatuam si vijon:

Ligji nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje, me nenin 55, ka rregulluar çështjen e Kompetencës dhe përbërjen e gjykatës, kësisoj paragrafi 1 përcakton se, gjykata gjykon në kufijtë e kompetencës së saj lëndore të paraparë me ligj, ndërsa në paragrafin 4 thuhet se, për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet dhe sanksionin kundërvajtës, mund ta shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike, në tekstin e mëtutjeshëm, organi për kundërvajtje të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje. Neni 56 i Ligjit Për Kundërvajtje, ka rregulluar Kompetencën e organit të kundërvajtjes, kështu në paragrafin 1 thuhet se, organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj, ndërsa paragrafi 2 parasheh që, përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, organi për kundërvajtje është kompetent që të veprojë sipas të gjitha kundërvajtjeve ashtu që: nën-paragrafi 2.1. specifikon, për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; nën-paragrafi 2.2. për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik, gjoba deri në pesëqind (500) euro; nën-paragrafi 2.3., për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik, gjoba deri në njëmijë (1.000) euro dhe nën-paragrafi 2.4., për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend.

Për të përcaktuar kompetencën në situatën kur rrezikohet trafiku publik i cili rezulton me lëndime të lehta trupore, seanca e përgjithshme e kësaj gjykate konstaton se Gjykata Themelore përkatëse, lëndore - Divizioni për Kundërvajtje është kompetent për trajtimin e kësaj kundërvajtje. Deri te një konstatim i tillë, gjykata erdhi duke analizuar nenin 109 të Ligjit për Kundërvajtje e që rregullon çështjen e ekspertimit në të cilin në paragrafin 1 thuhet se: "Ekspertimi caktohet me propozimin e palëve kur për konstatimin ose për vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm duhet të sigurohet konstatimi dhe mendimi nga personi, i cili ka njohuri të nevojshme profesionale, pastaj

se: "Gjykata, sipas detyrës zyrtare mund të caktojë ekspertimin, nën kushtet e përcaktuara me ligj", dhe paragrafi 3 se: "Ekspertimi caktohet me urdhëresën me shkrim të gjyqtarit, i cili e zhvillon procedurën". Në urdhëresë do të shënohet lidhur me cilat fakte duhet të bëhet ekspertimi dhe kujt i besohet. Kësisoj, nëse rrezikohet trafiku publik dhe rezulton me lëndime të lehta trupore, lidhur me natyrën e lëndimeve, duhet të sigurohet konstatim dhe mendim nga personi i cili ka njohuri të nevojshme profesionale, gjë që, në rastin konkret, për natyrën e lëndimeve trupore duhet mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor. Përveç kësaj situate ligjore, Ligji nr.06/L-069 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 Për Rregullat e Trafikut Rrugor, në nenin 26, shprehimisht përcakton se, "teksti i nenit 259 të ligjit bazik, zëvendësohet me tekstin "Polici i cili e rregullon dhe e mbikëqyrë trafikun rrugor, në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes shqipton gjobë me të holla deri në pesëqind (500) euro për personin fizik dhe njëmijë (1,000) euro për personin juridik, duke përfshirë edhe shqiptimin e masës mbrojtëse dhe pikët negative. Kundërvajtjet më gjobë të parapara mbi këtë shumë duke përfshirë edhe shqiptimin e masës mbrojtëse dhe pikët negative procedohen në gjykatën kompetente".

Edhe pse në mënyrë specifike, ligjvënësi nuk ka përcaktuar se për lëndime të lehta trupore, a mundet polici, i cili e rregullon dhe mbikëqyr trafikun rrugor në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes, të shqiptoi gjobë në të holla, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, një gjë të tillë, nuk ka të drejtë ta bëjë pikërisht për shkak se kemi të bëjmë me vërtetimin e natyrës së lëndimit trupor, i cili duhet të konstatohet ashtu siç u tha në procedurë të mëtutjeshme dhe kjo provë nuk mund të sigurohet në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes, pasi që duhet mendimi dhe konstatimi i ekspertit të lëmisë përkatëse dhe varësisht prej natyrës së lëndimeve më tutje, përcaktohen se a ka elemente të kundërvajtjes apo veprës penale. Po ashtu, siç u citua më lartë, edhe dispozita e nenit 26 e Ligjit për ndryshimin e ligjit për rregullat e trafikut rrugor, që përveç kundërvajtjeve të parapara për shqiptimin e gjobave mbi shumat e cekura, nëse parashihet shqiptimi i masës mbrojtëse dhe pikët negative, atëherë rastet procedohen në gjykatën kompetente.

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 370 të KPK-së në fuqi, tani më nuk parashihet vepër penale, Rrezikimi i trafikut publik, e cila rezulton me lëndime të lehta trupore dhe për këtë arsye, të gjitha rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, e të cilat kanë rezultuar me lëndime të lehta trupore, organi i kundërvajtjes duhet t'i parashtrojë Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes Gjykatës kompetente themelore – Divizionit për kundërvajtje.

Meqenëse Kodi Penal në fuqi me nenin 433 ka shfuqizuar Kodin nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-129 si dhe Ligjin nr. 04/L-273, në kuptim të nenit 3 të këtij Kodi të zbatimit të institutit të ligjit më të favorshëm që si parim përcakton se në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm e që në rastin konkret kemi këtë situatë, atëherë ashtu siç u cek në piken c) dhe d) të këtij Udhëzimi, lëndët të cilat janë në punë në gjykatat themelore të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit, në të cilat nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor duhet të hidhen në bazë të nenit 253 paragrafi 1 pika 1.1 KPPK , pasi që tani vepra me të cilën akuzohen nuk përbën vepër penale, ndërsa nëse ka filluar shqyrtimi gjyqësor, gjykata duhet ta vendos në bazë të aktgjykimit refuzues, bazuar në nenin 363 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPK-së. Gjithashtu, në kuptim të nenit 3 paragrafi 3 të KPK-së, i cili përcakton se: "Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar", atëherë duhet vepruar sipas kësaj dispozite ligjore, sa i përket ekzekutimit të dënimit.